

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "Black Eagle Express" Sh.p.k.

Sot, më datë 13/02/2024,

- **Z. Leonard Gjeka**, shtetas shqiptar, lindur me 18.01.1982, në Shkodër, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. Personal I20118020C, madhor e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

- **Znj. Xhesika Gjeka**, shtetase shqiptare, lindur me 20.09.1997, në Korçë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. personal J75920095D, madhore e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Black Eagle Express " Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Black Eagle Express " Sh.p.k.**

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bashkia Lezhë, Njësia Administrative: Shëngjin, Fshati: Ishull Shëngjin, Rruga "Zemra e Katundit", Godina 5, Amb.ndihmese,H 1.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Veprimtari në fushën e real estate;
- Shitje-Blerje, dhenie me qera e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;
- Dhenie me qera e automjeteve;
- Agjensi për shërbime imobiliare;
- Konsulencë, shërbime në fushën e pasurive të paluajtshme, duke përfshirë shitje, blerje, marrje e dhënie me qira;
- Blerja, shitja, dhenia me qira e pronave të paluajtshme si edhe ndërmjetesimi për shitje blerje apo dhenie me qera të pronave të paluajtshme midis personave fizike, personave juridike private dhe publike;
- Konsulencë imobiliare, zyre ndërmjetesi për pasuritë e paluajtshme e aktivitet ndërmjetesimi për pasuritë e paluajtshme;

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme

pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 2.000.000 Lek (*dy milion lek*) dhe është i përbërë nga dy kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Leonard Gjeka**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 Lek (*një milion lek*) dhe 1.000.000 Lek (*një milion lek*) të kapitalit themeltar.
- **Znj. Xhesika Gjeka**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 Lek (*një milion lek*) dhe 1.000.000 Lek (*një milion lek*) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Z. Leonard Gjeka, shtetas shqiptar, lindur me 18.01.1982, në Shkodër, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. Personal I20118020C, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (*dy*) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Leonard Gjeka** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

LEONARD GJEKA

XHESIKA GJEKA